REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI BASHKIAK
LUSHNJE

Nr 11432

Lushnjë më 19 / 11 /2026

Lënda:Thirrje mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës te këshillit bashkiak Lushnje.

ANËTARËVE TË KESHILLIT BASHKIAK LUSHNJE

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË
LUSHNJE
PREFEKTIT TE QARKUT FIER

-Në mbështetje te nenit 53 pika 4 ,neni 56 pika 2 ,shkronja"a" te ligjit 139/2015"Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar ,njoftoj thirrjen e mbledhjes së radhes te këshillit bashkiak Lushnje në sallën e këshillit bashkiak **diten e Premte date 27.11.2026 ora 10:00** me këtë rend dite:

1-Miratimi i rendit te ditës.
2-Projekt –Vendim: Për miratimin e fondit për familjet në nevojë që do te trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike si dhe ato që do të trajtohen me fondet e buxhetit vendor per muajin **Tetor** 2026 .
KOMISIONI PERGJEGJËS:KOMISIONI JURIDIK, RENDIT DHE SITUATAVE EMERGJENTE,KOMISIONI I EKONOMISE PROBLEMEVE SOCIALE DHE STREHIMIT.
3-Projekt–Vendim:Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin social për vitin 2027.
KOMISIONI PERGJEGJËS: KOMISIONI JURIDIK, RENDIT DHE SITUATAVE EMERGJENTE,KOMISIONI I EKONOMISE PROBLEMEVE SOCIALE DHE STREHIMIT.
4-Projekt–Vendim:Për përfundimin e procedurës së privatizimit të banesave shtetërore të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në A.Sh.K. D.V Lushnje.
KOMISIONI PERGJEGJËS:KOMISIONI JURIDIK, RENDIT DHE SITUATAVE EMERGJENTE
5-Projekt–Vendim:Për përditësimin e inventarit të miratuar me V.K.M-në nr 175 datë 06.03.2012"Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtëshme publike ,shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Lushnje të qarkut Fier ,për pasuritë me numër 4/47,22/129,18/12,18/51,5/45,2/36,1/58,1/65,1/54,10/53dhe 10/82 ,të llojit vendstrehim ,të ndodhura ne ZK.8571 dhe 8572".
KOMISIONI PERGJEGJËS:KOMISIONI JURIDIK, RENDIT DHE SITUATAVE EMERGJENTE.

6- **Projekt–Vendim:**Për krijimin e muzeut etnografik në Njesinë Administrative Kolonje ,Bashkia Lushnje .

KOMISIONI PERGJEGJËS:KOMISIONI JURIDIK, RENDIT DHE SITUATAVE EMERGJENTE,KOMISIONI I ARSIM ,KULTURE, SPORT.

7-**Projekt–Vendim:** Për miratimin e bursave të shtetit për nxënësit e arsimit profesional parauniversitar në institucionet arsimore publike për vitin arsimor 2026-2027.

KOMISIONI PERGJEGJËS:KOMISIONI JURIDIK, RENDIT DHE SITUATAVE EMERGJENTE, KOMISIONI I ARSIM ,KULTURE SPORT.

8- **Projekt–Vendim:**Për miratimin e përdorimit dhe percaktimin e tarifës së dhënies me qira të shtëpizave të drurit për festat e fundvitit,në sheshin para bashkisë.

KOMISIONI PERGJEGJËS:KOMISIONI JURIDIK, RENDIT DHE SITUATAVE EMERGJENTE.

9- **Projekt–Vendim:**Për miratimin e linjës së transportit të fëmijëve të kopshtit Arrës në Shkollën e Bashkuar "Pasho Kurti",Ngurrëz e Madhe.

KOMISIONI PERGJEGJËS:KOMISIONI JURIDIK, RENDIT DHE SITUATAVE EMERGJENTE, KOMISIONI I BUJQESISE ,URBANISTIKES DHE SHERBIMIT PUBLIK.

10-Shqyrtim i kërkesës nr 885 date 09.09.2026 nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh.A me lëndë"Kërkohet dhënie mendimi i Këshillit Bashkiak për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm,shërbimin e kanalizimeve dhe tarifat fikse".

11-Informacion mbi vakancën e krijuar të Kryetarit të fshatit Ngurrëz e Madhe ,Njësia Administrative Krutje ,dhe te Kryetarit te fshatit Golem i Vogël ,Njësia Adminisrative Golem.

12-Miratimi i proçesverbalit.

Shënim: Sjell në vëmendje te Kryetarëve te Komisioneve V.K.B-në nr. 37 date 24.04.2020"Mbi miratimin e rregullores së funksionimit te këshillit bashkiak Lushnje"dhe konkretisht nenet 34,35,36,37,38.

-Duke ju falenderuar!

KRYETARI
Erjet Dhima

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE